



KOMUNA E RAHOVECIT

OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC

KONTRATË

Emri i Autoritetit Kontraktues: **KOMUNA E RAHOVECIT**, në njërën anë; dhe

Emri i Kontraktuesit: **“GZIMI–GARTEN–UND LANDSCHAFTSBAU” Sh.p.k. me adresë në Rahovec, të cilën e përfaqëson Petrit Veliu**

Janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për:

TITULLI I KONTRATËS: DEKORIMI I QYTETIT PËR FESTAT E FUNDVITIT – RITENDERIM

Numri i Prokurimit: 623-19-9260-2-3-6

Numri i Brendshëm: 623-19-079-2-3-6

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: **Dekorimi i qytetit për festat e fundvitit – Ritenderim**, sipas specifikimeve teknike të detyrueshme dhe pjesës së ofertës financiare që janë pjesë e kësaj kontrate.

1.2 Kontrata hynë në fuqi me: **datën e nënshkrimit** dhe përfundon për një periudhë prej **1 muaj**.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se [2] ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë: **Në Komunën e Rahovecit**.

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **6,990.00** Euro;

(Gjashtëmijë e nëntëqindnëntëdhjetë Euro e zero zero Cent).

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Autoriteti Kontraktues do të paguaj secilën shumë të detyrimeve pas pranimit të secilës dërgesë:

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i Shërbimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të shërbimeve.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore


13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [Gjykata Themelore Prishtinë] në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi




14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën [Shqip]² në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.





Për Operatorin Ekonomik:		Për Autoritetin Kontraktues:	
Emri:	Petrit Velu	Emri:	Astrit Mullabazi
Pozita:	Drejtor	Pozita:	Menaxher i prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	18.12.2019	Data:	18.12.2019
Vula:		Vula:	


² Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.




PARAMASA DHE PARALLOGARIA PËR DEKORIMIN E QYTETIT PËR FESTAT E FUNDVITIT


PARAMASA DHE PARALLOGARIA PËR DEKORIMIN E QYTETIT PËR FESTAT E FUNDVITIT						
Nr.	Pershkrimi / Poshionit	Foto (modeli i ngjajshëm)	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
	Punët e Ndrëqimit					
1	Vendosja e bredhit edhe ndriqimit ekzistues në qendër të qytetit. Në çmim të llogaritet furnizimi me kablo elektrike adekuate furnizuese dhe përcjellëse, si dhe sajlle apo litarë për përforcimin e bredhit dhe dritave dekoruese. Dizajni i vendosjes së ndriqimit do të bëhet nga autoriteti kontraktues. Në çmim të llogaritet edhe largimi i bredhit dhe dekorimeve pas përfundimit të festave, transporti dhe deponimi në vendin e caktuar nga autoriteti kontraktues.		komplet	1	500	500.00
2	Furnizimi me material, transporti dhe montimi i figurave dekoruese me forma të ndryshme: si psh. fjollave të dëborës, zileve, yjeve, kaproje etj. Madhësia minimale 50x50cm. Në çmim të llogaritet furnizimi me kablo për kyqje, vendosja e tyre, si dhe largimi i tyre pas festave dhe vendosja në vendin e përcaktuar nga autoriteti Komunal.		copë	30.00	15.00	450.00
3	Furnizimi, transporti dhe montimi i figurave dekoruese me forma të ndryshme: si psh. fjollave të dëborës, zileve, yjeve, kaproje etj. Madhësia rreth në 100x100cm. Në çmim të llogaritet furnizimi me kablo për kyqje, vendosja e tyre, si dhe largimi i tyre pas festave dhe vendosja në vendin e përcaktuar nga autoriteti Komunal.		copë	20.00	15.00	300.00








4	Furnizimi, transporti dhe montimi i dritave dekoruese LED me ngjyra me gjatësi 10m. Në çmim të llogaritet furnizimi me kablo për kyqje, vendosja e tyre, si dhe largimi i tyre pas festave dhe vendosja në vendin e përcaktuar nga autoriteti Komunal.		copë	80.00	10.00	800.00
5	Furnizimi, transporti dhe montimi i dritave dekoruese LED në degët për gjatësi 20m. Në çmim të llogaritet ndryshme me kablo për kyqje, vendosja e tyre, si dhe largimi i tyre pas festave dhe vendosja në vendin e përcaktuar nga autoriteti Komunal.		copë	90.00	5.00	450.00
6	Montimi i dritave ekzistuese në formë perde me dim. 1.5x8m. Në çmim të llogaritet kyqje në kabllo të rrymës, vendosja e tyre, si dhe largimi i tyre pas festave dhe vendosja në vendin e përcaktuar nga autoriteti Komunal.		copë	10.00	15.00	150.00
7	Furnizimi, transporti përforcimi dhe montimi i dritave në formë të zemrës me dimensione 1,8x1,8x0,4m' e punuar nga dritat gypore pereth si dhe pjesa e sipërfaqes së mbuluar në brendi duhet të jetë me dritat vizëluese si në fotot po ashtu edhe ngjyra të pershtatet si ne foto.		copë	1.00	100.00	100.00
	Furnizimi, transporti dhe montimi i dritave në formë të zemrave me dimensione 1,0x1,0 m' e punuar nga dritat gypore pereth si në fotot po ashtu edhe ngjyra të pershtatet si ne foto.		copë	4.00	20.00	80.00





8	Furnizimi, transporti dhe montimi i dritave në formë perde me dim. 1.5x8m. Në çmim të llogaritet furnizimi me kablo për kyqe, vendosja e tyre, si dhe largimi i tyre pas festave dhe vendosja në vendin e përcaktuar nga autoriteti Komunal.		copë	8.00	20.00	160.00
9	Furnizimi me material, transporti dhe vendosja e dritave dekoruese kollor me rrotullim , vendosja behet ne vendet e caktuara nga autoriteti kontraktues, në çmim të llogaritet edhe kabllo elektrike furnizuese.ndriques te jashtem-Laser dekorues me forma me pika ,yje ose te ngjajshme. Vërejtje: Duhet të jenë rezistent ndaj shiut dhe bores me mbrojtje adekuate.		copë	8.00	20.00	160.00
10	Furnizimi transporti dhe montimi dhe përforcimi i numrave 2020 të punuara prej armaturave prej hekuri.Numrat të jenë me dimensione:200x300cm secila.Pjesa e numrave 0 të jetë hapur në pjesën e poshtme në mënyrë që të bëhet kalimi i njërzëve nëpërmjet tyre (në formë të portës). Numrat të punëhen me mbushje prej armaturave me elemente dekorative.Në çmim të llogaritet edhe furnizimi me drita vezulluese, montimi i dritave për ndriçim në kohë të festave.		komplet	1.00	800.00	800.00



11	Furnizimi, transporti dhe montimi i figurave në formë të portave hyrëse, të punuara prej armaturave prej hekuri. Figurat të jenë me dimensione: 240x300cm me lartësi h=250cm secila. Pjesa e figurave të jetë hapur në pjesën e poshtme në mënyrë që të bëhet kalimi i një rrëzeve nëpërmjet tyre (në formë të portës). Figurat (portat) të punohen me mbushje prej armaturave me elemente dekorative. Në çmim të llogaritet edhe furnizimi me drita vezulluese, montimi i dritave për ndriçim në kohë të festave.		copë	2.00	400.00	800.00
12	Furnizimi me material, transporti dhe montimi i figurave dekoruese me formë të kaprollit. Madhësia të jetë 150x200x40cm. Në çmim të llogaritet ndriçimi i tyre me drita dekoruese, furnizimi me kablo për kyqje, vendosja e tyre, si dhe largimi i tyre pas festave dhe vendosja në vendin e përcaktuar nga autoriteti Komunal.		copë	2.00	150.00	300.00
13	Furnizimi, transporti dhe montimi i tendes me dimensione 400x400x240cm, tenda është nga profilet metalike si dhe duhet të jetë e ankeruar si dhe e mbuluar për mbrojtjen nga të reshurat atmosferike. Tenda duhet të dekorohet me dritat si dhe me elementet tjera perçellessi per festat e fundvitit si topat ndriquese, shiritat dekoruese etj.		copë	1.00	500.00	500.00
14	Angazhimi i dy personave të gjinisë mashkullore si dhe femrore me veshje të Babadimit gjatë orarit 16:00 deri në ora 18:00 dhe prej orës 20:00 deri në orën 22:00, duke llogaritur për tre netë rrallëzi prej datës 28.29 dhe 30 dhjetor 2019.	 	copë	2.00	100.00	200.00



15	Furnizimi me material i shirit dekorues me gjersi 50cm për punimin e fjongove me dimensione min 1.7m-2m-me ngjyrë të kuqe dhe ari (shkëlqim dhe mat). Sasia duhet jetë gjysma të kuqe dhe gjysma ngjyrë ari.	 	copë	12.00	20.00	240.00
16	Furnizimi dhe montimi i shiritave dekorative me gjersi 5cm për punimin e fjongove me ngjyrë të ndryshme ku në cmim llogaritet per metër gjatësi.		m	500.00	2.00	1,000.00
				Gjithësej:		6,990.00

Vërejtje: Të gjitha dekorat pas përfundimit të festave të largohen dhe të vendosen në vendin e përcaktuar nga autoriteti kontraktues.

